

Opinion ligjor “Mbi kuadrin ligjor për Vullnetarizmin dhe zbatueshmërinë e tij”

Për qëllime të këtij Opinioni janë marrë në analizë përmbajtja e Ligjit 45/2016, relacioni i projektligjit përkatës gjatë procesit të miratimit të tij, aktet nënligjore përkatëse të cilat tashmë janë miratuar, dispozita të tjera të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Objekti dhe Qëllimi i Ligjit 45/2016

Ligji 45/2016 është akti kryesor ligjor për rregullimin në mënyrë specifike formale të vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë. Neni 2 i Ligjit 45/2016 parashikon shprehimisht se ky ligj synon rregullimin ligjor të vullnetarizimit, me qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor.

Pavarësisht nga rregullimi sipas Ligjit 45/2016, duhet mbajtur parasysh që vullnetarizmi është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore që çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë mund ta ushtrojë si një e drejtë për t'i dhënë kontribute kujdo që ka nevojë dhe/ose për interes publik. Në lidhje me veprimtarinë në interes të publikut që ka lidhje edhe me qëllimin e vullnetarizmit, kujtojmë që Ligji nr.8788, datë 7.5.2001 “PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE”, i ndryshuar, parashikon në Nenin 2 pika 5 kuptimin e veprimtarisë në të mirë dhe interes të publikut. Me veprimtari ‘në të mirë dhe interes të publikut’ kuptohet çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individi dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

Sipas përcaktimeve të shprehura në Ligjin 45/2016, ai synon të rregullojë formalizimin e marrëdhënies midis Përfituesit të Vullnetarizmit dhe Ofruesit të Vullnetarizmit dhe, mbi të gjitha, të këtij të fundit me Vullnetarin.

Kontributet që jep Vullnetari nëpërmjet vullnetarizmit

Vullnetarizmi është një e drejtë që kushdo mund ta ushtrojë si një e drejtë për të dhënë pa kundërshtim kontribute në para, natyrë apo shërbime, kujdo që ka nevojë dhe/ose për interes publik. Sipas Ligjit 45/2016, vullnetarizmi përkufizohet si një vënie në dispozicion të kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari në dobi të

ofruesit/përfituesit të vullnetarizmit (Neni 4(1)). Neni 4(2) parashikon në mënyrë të shprehur se “Vullnetarizmi kryhet pa pagesë, pa kompensim ose ndonjë përfitim tjetër material, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe”.

Subjektet e Vullnetarizmit

Ligji 45/2016 parashikon subjektet e vullnetarizmit:

- Neni 9 parashikon se “1. Ofrues i vullnetarizmit mund të jetë një organ publik, bashkësi fetare ose organizatë jofitimprurëse. 2. Ofrues i vullnetarizmit mund të jetë edhe një person juridik vendas ose i huaj, i cili në ofrimin e vullnetarizmit, në përputhje me këtë ligj, nuk synon veprimtari fitimprurëse”. Nga analiza e nenit 9 të Ligjit duket qartë se objekti i veprimtarisë vullnetare nuk është në asnjë rast fitimi. Ky përfundim del jo vetëm nga pika 1 e këtij neni, në të cilën janë renditur subjekte të cilat nuk kanë objekt fitimin, por edhe nga pika 2 e Neni 9 ku përcaktohet se shërbimi i vullnetarizmit mund të ofrohet edhe nga personat juridikë, duke u kuptuar këtu edhe shoqëri tregtare, është i përjashtuar nga fitimi.
- Sipas Ligjit 45/2016, Përfitues të Vullnetarizmit mund të jenë të gjithë personat fizikë (individët) ose juridikë, vendas ose të huaj (Neni 10(1)) sikurse dhe vetë Ofruesi i Vullnetarizmit (neni 10(2)).
- Sipas Neni 5 të Ligjit 45/2016, Vullnetari është çdo person, vendas ose i huaj, i cili gëzon zotësi të plotë për të vepruar dhe që me vullnet kryen vullnetarizëm, çdo person me aftësi të kufizuara dhe çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç.

Sa më sipër, është e rëndësishme për efekte të analizës së Ligjit 45/2016.

Marrëdhënia e Vullnetarizmit

Siç shkruhet më sipër, Ligji 45/2016 synon të rregullojë, mbi të gjitha, formalizimin e marrëdhënies midis Ofruesit të Vullnetarizmit dhe Vullnetarit. Sipas përcaktimeve të Ligjit 45/2016, vullnetarizmi mund të interpretohet se ngjason me marrëdhënien juridike të punës, sikurse dhe me atë të shërbimit, përderisa ajo ka për objekt vënien në dispozicion të aftësive dhe njohurive për kryerjen e një shërbimi të caktuar, por ka dallime thelbësore prej tyre.

Këto dallime dalin nga natyra specifike e vullnetarizmit, natyrë e cila është e materializuar në një ligj të posaçëm që e dallon këtë veprimtari nga ajo e punës (e cila rregullohet nga Kodi i Punës dhe legjislacioni i shërbimit civil ose ai i nëpunësve politikë të administratës publike) dhe nga marrëdhënia juridike e shërbimit (e ofruar bazuar në Kodin Civil apo Ligjit 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”). Ligji 45/2016 synon të bëjë këtë dallim nga marrëdhënia e punës dhe e shërbimit, por dispozitat përkatëse nuk janë të qarta dhe nuk arrihet të identifikohet çfarë marrëdhënie e veçantë ligjore apo kontraktore krijohet midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizmit.

Ligji 45/2016 parashikon shprehimisht që vullnetarizmi rregullohet nga Kontrata e Vullnetarizmit,

e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e vullnetarit dhe kushtet e kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare (Neni 14). Neni 15 cakton edhe elementët e detyrueshëm që duhet të përmbajë Kontrata e Vullnetarizmit. Neni 16 përcakton se “1. Me lidhjen e kontratës së vullnetarizmit, të drejtat që kanë lindur nga papunësia nuk humbasin. 2. Kontratat e vullnetarizmit, që lidhen me qëllim shmangien e lidhjes së një kontrate pune, janë të pavlefshme”. Nga analiza e kësaj dispozite, evidentohet qartë se marrëdhënia juridike e vullnetarizmit nuk interferon në asnjë rast me marrëdhënien juridike të punës dhe nuk mund të barazohet me një të tillë. Në Nenin 16(1) përcaktohet se kjo kontratë nuk zëvendëson të drejtat që kanë lindur nga papunësia, të cilat janë të drejta të natyrës social-ekonomike. Pjesë e këtyre të drejtave është edhe mbrojtja nga sigurimet shoqërore. Kjo dispozitë jep bazë që të interpretohet që Ofruesi i Shërbimit të mos këtë detyrime për sigurime shoqërore shëndetsore, por Ligji 45/2016 nuk e qartëson këtë aspekt.

Duhet të mbajmë parasysh se në skemën e sigurimeve shoqërore një person ka statusin ose të kontribuesit ose të përfituesit. Me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 8 (para. 3), parashikohet se “Periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak [... të papunësisë]. Kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse.” Nisur nga ky parashikim, në vështrim edhe të Nenit 16(1), një vullnetar i cili nuk është i punësuar, do të vijojë përfitimin nga mbrojtja e sigurimeve shoqërore, pasi periudha për të cilën vijon të jetë i papunë i njihet si periudhë e vlefshme për efekt pensioni pleqërie. Sa kohë që Ligji 45/2016 shkruan shprehimisht që Vullnetarit nuk i humbasin të drejtat që lindin nga papunësia, atëherë bëhet interpretimi që për këtë vullnetar nuk duhet të paguhen sigurime shoqërore, për kohën kur punon si vullnetar. Megjithatë, Neni 22 e shton konfuzionin kur parashikon për kontributet, sigurimin, etj., që duhet të kryhet për Vullnetarin (shih më poshtë).

Në lidhje me nenin 22, ky nen nuk është i qartë se çfarë mbulimi duhet të bëjë Ofruesi i Vullnetarizimit për Vullnetarët përkatës. Së pari, nuk bëhet dallimi midis pagimit të kontributeve dhe sigurimit (pra, nëpërmjet një police) dhe, së dyti, nëse është synuar pagimi i kontributeve, nuk është qartësuar se cilat kontribute duhen paguar duke patur parasysh Nenin 14 të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar:

“Neni 14

Shpërndarja e kontributeve

1. Kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen në tri degë që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore:

a) dega e sigurimit të sëmundjeve 1,5 për qind e shumës së listëpagesave; b) dega e sigurimit të barrë lindjes 2,8 për qind e shumës së listëpagesave; c) dega e sigurimit të pensioneve 31,7 për qind të shumës së listëpagesave;

2. Punëdhënësi, përveç kësaj paguan:

a) te dega e sigurimit të aksidenteve dhe e sëmundjeve profesionale 0,5 për qind të shumës së

Janar 2021

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Tiranë, Shqipëri 2020

listëpagesave;

b) te dega e sigurimit të papunësisë 6,0 për qind të shumës së listëpagesave.”

Më tej, në nenin 16(2) të Ligjit 45/2016 parashikohet se është kusht pavlefshmërie absolute përdorimi i një kontrate vullnetarizmi për të mbuluar një marrëdhënie pune. Kjo, pasi ndërmjet këtyre dy marrëdhënieve ka një ndarje thelbësore. Ky parashikim është i paqartë dhe i jep diskrecion organeve përkatëse pasi këto të fundit mund të deklarojnë të pavlefshme një kontratë vullnetarizmi dhe ta kualifikojnë atë si kontratë pune apo shërbimi dhe, mbi këtë bazë, të ngarkojnë penaltete për Ofruesin e Vullnetarizmit, etj. Dispozita më sipër, duhet të mënjanohet nga Ligji 45/2016 sa kohë që kushtet e pavlefshmërisë së kontratave konstatohen dhe deklarohen sipas kushteve dhe parashikimeve në kodet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Detyrimet e Ofruesit të Vullnetarizimit kundrejt Detyrimeve të Punëdhënësit ose Blerësit të Shërbimit

Nga analiza e dispozitave që përcaktojnë të drejtat e vullnetarit (Neni 19) dhe detyrimet e ofruesit të vullnetarizmit (Neni 21) rezulton se, në asnjë rast, nuk parashikohet detyrimi i Ofruesit të Vullnetarizmit që të paguajë sigurimet shoqërore në favor të Vullnetarit. Kjo pasi, në rast se ky i fundit është i punësuar, sigurimet i paguhen në kuadër të marrëdhënies së punës e, në rast se është i papunë, të drejtat për sigurimet mbulohen sipas Ligjit 7703/1993. I vetmi sigurim që paguhet në favor të vullnetarit është sigurimi i shëndetit për vullnetarin sipas Nenit 22 të Ligjit 45/2016 (të sigurohet Vullnetari nga aksidentet dhe sëmundjet; me pas, shkruhet se Ofruesi i Vullnetarizmit duhet t'i japë Vullnetarit një kopje të kontratës së sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve). Kjo dispozitë nuk është e qartë për të përcaktuar se çfarë mbulimi duhet të bëjë Ofruesi i Vullnetarizimit për Vullnetarët.

Më tej, në nenin 9 të Ligjit 7703/1993 përcaktohet se “Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrë lindje dhe pensione, në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto). Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore. Punëdhënësit detyrohen të paguajnë kontribut për aksident në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësinë. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrë lindje dhe për pensione të llogaritura, për një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale kontributive. Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione, mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi. Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione. Masat dhe kriteret caktohen nga Këshilli i Ministrave. Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike, të zhvilluar më parë, për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me ligje dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.”

Janar 2021

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Tiranë, Shqipëri 2020

Bazuar në sa më sipër, edhe në vështrim të nenit 9 të Ligjit 7703/1993, rezulton se marrëdhënia juridike e vullnetarizmit nuk është marrëdhënie punësimi dhe nuk zëvendëson në asnjë rast efektet e kësaj të fundit në raport me përfitimet sociale të vullnetarit. Në këto kushte, ajo nuk është subjekt i detyrimit për të paguar kontributet shoqërore në favor të vullnetarit, dhe as detyrime të tjera të natyrës fiskale. Nëse do të aplikohesh një skemë e tillë, jo vetëm që do të dilte nga korniza e vullnetarizmit, por do e shndërronte marrëdhënien juridike të vullnetarizmit në një situatë juridike me elementë pavlefshmërie absolute. Në rrethana të tilla, Ofruesi i Vullnetarizimit nuk ka detyrim të paguajë kontribute për sigurime shoqërore në favor të Vullnetarit përderisa marrëdhënia juridike e vullnetarizmit nuk është përcaktuar në fushën e veprimit të nenit 9 të Ligjit 7703/1993.

Në lidhje me këtë pikë është e rëndësishme që të qartësojmë edhe që, nga pikëpamja strikte ligjore, një organizatë nuk mund të kontrakttojë një kontratë shërbimi me një individ që nuk ka regjistrim tregtar. Në këto kushte, për marrëdhënien e vullnetarizmit nuk mund të bëhet analogji me marrëdhënien e shërbimit.

Personat Juridikë si Ofrues të Vullnetarizmit

Pika 2 e Nenit 9 të Ligjit 45/2016 përcakton se shërbimi i vullnetarizmit mund të ofrohet edhe nga personat juridikë, duke u kuptuar këtu edhe shoqëri tregtare, por që nuk synon veprimtari fitimprurëse nëpërmjet ofrimit të vullnetarizmit.

Sigurisht që edhe shoqëritë tregtare janë kontribuese për interes publik, por në formën klasike subjektet fitimprurëse mund të japin kontribut me interes publik nëpërmjet dhënies së donacioneve, etj. Ofrimi i vullnetarizmit nga shoqëritë tregtare, duhet të shoqërohet me akte nënligjore përkatëse për të përcaktuar kufirin midis veprimtarisë fitimprurëse dhe jo fitimprurëse kur subjektet fitimprurëse shfaqen si Ofrues të Vullnetarizmit. Ligji 45/2016 nuk ka parashikuar shprehimisht një hapësirë që qartësimi i mësipërm të bëhet me akt nënligjor.

Paqartësia në sa është shkruar më sipër, sjell vështirësi në mënyrë të tërthortë edhe për ushtrimin e vullnetarizmit nga OJF, të cilat mund të paragjykojnë për analogji me shoqëritë tregtare nga organet përkatëse dhe të jenë subjekt i detyrimeve dhe penalteteve (shih më poshtë në pjesën ‘Përfundime’ në lidhje me penaltetet).

Përfundime

1. Ligji bën përpjekje për të rregulluar angazhimin si vullnetar, ndërkohë që ky angazhim është me vullnet dhe duhet të jetë me vullnet¹ dhe vullnetarizmi të shprehet sa herë që një person mendon

¹ Instrumentet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me punën e detyruar janë: a) Konventa nr. 29 “Mbi punën e detyruar” e vitit 1930; b) Konventa nr. 105 “Mbi ndalimin e punës së detyruar”, e vitit 1957.

që mund të kontribuojë për të mirën dhe interesin publik.

2. Mbajtja e Regjistrimit të Vullnetarëve (baza e të dhënave) sipas përcaktimeve të Ligjit nr.45/2016 nuk ka vlerë të shtuar dhe nuk është mjeti efektiv për të motivuar vullnetarizimin në Shqipëri. Ligji nuk përcakton qëllimin e mbajtjes së Regjistrimit të Vullnetarëve. Ky qëllim duhet të përcaktohet shprehimisht në ligj dhe Regjistri duhet të përdoret vetëm për qëllime të vlerësimit të punës vullnetare të individëve përkatës, duke qenë kështu në përputhje me qëllimin e Ligjit nr.45/2016 të përcaktuar në nenin 2 të tij.

3. Funkzioni i Regjistrimit të Vullnetarëve nuk duhet të jetë që të shërbejë si mjet evidentimi dhe burim prove për të ngarkuar me detyrime financiare dhe fiskale, kontribute, etj., organizatat Ofruese të Vullnetarizimit. Ligji duhet të jetë i qartë në këtë drejtim.

4. Ligji 45/2016 synon të bëjë dallimin e vullnetarizimit nga marrëdhënia e punës dhe e shërbimit, por dispozitat përkatëse nuk janë të qarta dhe nuk arrihet të identifikohet çfarë marrëdhënie e veçantë ligjore apo kontraktore krijohet midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizimit. Megjithatë, marrëdhënia e vullnetarizimit nuk mund të bëhet analogji me marrëdhënien e punës dhe të shërbimit, që të legjitimojë ngarkesën e marrëdhënies së vullnetarizimit me detyrime financiare, fiskale, etj.

5. Ligji 45/2016 nuk qartëson marrëdhënien që ndërtohet midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizimit. Ligji duhet të synojë ndërtimin e një marrëdhënie ku vullnetari të jetë i lirë të japë kontributin e tij dhe të mos bëjë ‘punë të detyruar’ sipas përcaktimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Jurisprudencës të GJEDNJ², apo Konventave përkatëse të ILO dhe organizata ofruese e vullnetarizimit të veprojnë në përputhje me objektin e aktivitetit për të cilin është krijuar dhe të maksimizojë përfitimin për interes publik nga puna vullnetare e individëve.

6. Sa kohë që Ligji 45/2016 shkruan shprehimisht që Vullnetarit nuk i humbasin të drejtat që lindin nga papunësia, atëherë bëhet interpretimi që për këtë vullnetar nuk duhet të paguhen sigurime shoqërore, për kohën kur punon si vullnetar. Neni 22 e shton konfuzionin kur parashikon për kontributet, sigurimin, etj., që duhet të kryhet për Vullnetarin (shih më poshtë).

7. Ligji 45/2016 kur parashikon për sigurimin e vullnetarëve, nuk është i qartë nëse Ofruesi i Vullnetarizimit duhet të paguajë kontributet për sigurime shoqërore e shëndetsore, nëse duhet të kufizohet në sigurimin për mbrojtje nga aksidentet në punë, etj., apo duhet të paguajë një policë sigurimi për sigurimin e jetës, etj. Në lidhje me sigurimin për aksidentet në punë, sigurimin e jetës, etj., Neni 22 nuk është i qartë se cilin lloj mbulimi duhet të bëjë Ofruesi i Vullnetarizimit për vullnetarët përkatës. Detyrimi përkatës i Ofruesit të Vullnetarizimit duhet të shkruhet shprehimisht në ligj, për të shmangur çdo lloj keqinterpretimi, dhe në përputhje edhe me parimin e sigurisë

² Van der Mussele kundër Belgjikës

juridike, si pjesë e rëndësishme e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës.

8. Neni 16 (2) është i paqartë dhe i jep diskrecion organeve përkatëse pasi këto të fundit mund të deklarojnë të pavlefshme një kontratë vullnetarizmi dhe ta kualifikojnë atë si kontratë pune apo shërbimi dhe, mbi këtë bazë, të ngarkojnë penalitete për Ofruesin e Vullnetarizmit, etj. Kjo dispozitë duhet të hiqet nga Ligji 45/2016.

9. Ofrimi i vullnetarizmit nga shoqëritë tregtare, duhet të shoqërohet me akte nënligjore përkatëse për të përcaktuar kufirin midis veprimtarisë fitimprurëse dhe jo fitimprurëse kur subjektet fitimprurëse shfaqen si Ofrues të Vullnetarizmit. Ligji 45/2016 nuk ka parashikuar shprehimisht një hapësirë që qartësimi i mësipërm të bëhet me akt nënligjor.

10. Ligji nuk parashikon penalitete të shprehura dhe nuk referon në ndonjë ligj të veçantë për të mundësuar legjitimitetin e vendosjes së penaliteteve ndaj Ofruesit të Vullnetarizmit, Vullnetarit apo Përfituesit të Vullnetarizmit. Në këto kushte, çdo kualifikim ligjor nga Inspektoriati i Punës, organet tatimore, i shkeljeve në lidhje me vullnetarizmin, është i pabazuar në ligj dhe duhet të kundërshtohet me mjetet përkatëse ligjore në varësi të kualifikimit që mund të bëhet në aktet administrative që duhet të lëshojnë këto organe kur penalizojnë subjekte të caktuara.

11. Ligji duhet të mundësojë fleksibilitet për rastet e vullnetarizmit masiv, të tilla si: fushata pastrimi, ndihmë në rastet e forcave madhore, etj. Në këto raste, organizatat të kenë vetëm detyrimin të mbajnë evidenca të vullnetarëve, por kjo mos të shoqërohet me asnjë detyrim financiar, etj., për vetë vullnetarët apo organizatat Ofruese të Vullnetarizmit.

Rekomandime:

1. Rekomandojmë që Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të lëshojë një Vendim Teknik me qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit që lidhen me efektet e Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, mbi të gjitha, në lidhje me detyrimet e Ofruesve të Vullnetarizmit për sigurimin e vullnetarëve përkatës. Po kështu, në këtë vendim teknik të qartësohet natyra e marrëdhënies formale të krijuar me kontratë midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizmit, në rastet kur marrëdhënia është e qëndrueshme.

2. Me qëllim që Ligji 45/2016 të nxisë në mënyrë efektive vullnetarizimin, ky ligj duhet të pësojë ndryshime, të cilat të përqëndrohen në pikat si më poshtë:

(i) Të mundësohet vullnetarizmi masiv pa barriera formale dhe detyrime financiare për Vullnetarët dhe organizatat Ofruese të Vullnetarizmit.

(ii) Rregullimi i vullnetarizmit me ligj të shmangë rregullimin e vullnetarëve në kuptimin që ata duhet të jenë të regjistruar në mënyrë që të ofrojnë vullnetarizëm.

(iii) Rregullimi me ligj i vullnetarizmit dhe, veçanërisht, përdorimi i Regjistrit të Vullnetarëve të bëhet në funksion të vlerësimit të kontributit të vullnetarëve në shoqëri dhe të shmangen

potencialet për keqperdorim të informacionit të Regjistrit për ngarkesa financiare, fiskale, etj., për Vullnetarët dhe organizatat Ofruese të Vullnetarizmit. Ligji të përcaktojë qartë dhe në mënyrë shtruese qëllimin dhe funksionin e Regjistrit.

(iv) Të qartësohet natyra e marrëdhënies ligjore dhe kontraktore midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizmit, kjo me qëllimin për të qartësuar, mbi të gjitha, detyrimet përkatëse tatimore, për kontributet, etj., dhe shmangiet ligjore nga këto detyrime. Marrëdhënia e vullnetarizmit nuk mund të jetë as marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie shërbimi.

(v) Dispozita e Nenit 16(2) duhet të hiqet nga Ligji 45/2016. Kushtet e pavlefshmërisë së kontratave konstatohen dhe deklarohen sipas kushteve dhe parashikimeve në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

(vi) Duhet të qartësohet edhe natyra dhe lloji i sigurimit për Vullnetarët sipas Nenit 22 për t'i hapur rrugën zbatimit të drejtë të ligjit nga të gjithë subjektet e interesuara (në mënyrë që qartësimi të mos mbetet vetëm i shpjeguar me një vendim teknik të DPT - shih rekomandimin 1 më sipër). Sigurimi i vullnetarit në skemën e sigurimeve shoqërore nga aksidentet në punë dhe për pension pleqërie duket me vend në marrëdhënien e vullnetarizmit; ky sigurim mund të bëhet nga shteti.

(vii) Pa kundërshtuar pikën (vi) më sipër, duke gjykuar mbi bazën e qëllimit të Ligjit nr.45/2016³ për mbështetjen dhe promovimin e vullnetarizmit, është e rekomandueshme që ligji të parashikojë mbështetje efektive për Vullnetarët; nëpërmjet skemave mbështetëse, shteti duhet të bëhet bartëse e detyrimeve për sigurime shoqërore, shëndetsore, etj., për Vullnetarët për kohën dhe mundin që Vullnetarët dedikojnë për interes publik, dhe të shmanget që kjo barrë t'i kalojë Ofruesve të Vullnetarizmit, përveçse kur si Ofrues i Vullnetarizmit është një organ publik.

(viii) Ligji 45/2016 duhet të parashikojë qartësi për ofrimin e vullnetarizmit nga shoqëritë tregtare dhe të parashikojë shprehimisht që detaje të qartësimit të mëtejshëm të ofrimit të vullnetarizmit nga shoqëritë tregtare të bëhen me akt nënligjor.

³ Neni 2 i Ligjit nr.45/2016

Janar 2021

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Tiranë, Shqipëri 2020